

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 315 Rep.

Nr. 127 Kol.



AKTI I THEMELIMIT  
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
NEW YORK UNIVERSITY - TIRANA Sh.p.k.

Sot me 11.042002, para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht:

1. Z. Ilias Foutsis, shtetas grek, lindur ne Messinias, me 09.09.1948, mbajtes i pasaportes me nr. M 524049;
2. Znj. Charikleta Zachariadou, shtetase greke, lindur ne Thessalonikis, me 28.07.1945, mbajtes i pasaportes me nr. O 819181;
3. Z. Genc Ruli, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, Shqiperi me 11.04.1958, mbajtes i pasaportes me nr. 0011318.

Persona madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u binda nga dokumentet identifikuese qe me paraqiten. Ata me vullnetin e tyre te plote e te lire, nenshkruan ne pranine time Aktin e Themelimit te shoqerise New York University -Tirana Sh.p.k.

- Ortaket themelojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin: New York University -Tirana Sh.p.k.
- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.
- Shoqeria ka per objekt te kryeje dhe te marre pjese ne te gjitha aktivitetet dhe bizneset qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne baze te legjislacionit shqiptar per ngritjen dhe funksioninin e nje shkolle te larte jo publike te nivelit universitar ne deget e shkencave te natyres, te artit dhe profesioneve te lira. Te organizoje programet e edukimit profesional, seminare, kurse per mesimin e gjuheve te huaja te te gjitha niveleve si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera te cilat kane objekt te ngjashem me te.
- Shoqeria e ka seline e saj ne adresen: Instituti i Studimeve Bashkekohore, Rruga "Vaso Pasha", nr.7, Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te hape filiale, dege dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.
- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar.
- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 3.000.000 Leke (tre milion leke) i cili eshte i ndare ne 300 (treqind) kuota me vlere nominale 10.000 Leke (dhjete mije) secila. Kapitali i shoqerise nenshkruhet dhe derdhet teresisht ne te holla, perkatesisht nga ortaket:

(i) Ilias Foutsis, zoteron 195 (njqind e nentedhjete e pese) kuota qe i korrespondojne 1.950.000 Leke ( nje milion e nentedhjete e pesedhjete mije), qe perfaqesojne 65 % te kapitalit themeltar te shoqerise;

(ii) Z. Genc Ruli, zoteron 75 (shtatedhjete e pese) kuota, qe i korrespondojne 750.000 Leke (shtateqind e pesedhjete mije), qe perfaqesojne 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise;

(iii) Zj. Charikleta Zachariadou, zoteron 30 (tridhjete) kuota, qe i korrespondojne 300.000 Leke (treqind mije), qe perfaqesojne 10% te kapitalit themeltar te shoqerise;

- Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i cili zgjidhet nga Asambleja e Ortakeve.

Administratori do te qendrojne ne detyre deri ne momentin e revokimit te mandatit te tij nga Asambleja e Ortakeve.

- Ortaket emerogjne administrator te pare te shoqerise Z. Ilias Foutsis, shtetas grek, lindur ne Messinias, me 09.09.1948, mbajtes i pasaportes me nr. M 524049.
- Administratori do te pergjigjet personalisht perballe shoqerise ose te treteve per shkeljet e mundshme te ligjit dhe/ose te statutit.
- Administratorit i njihet e drejta t'u delegeje me prokure personave te trete te zgjedhur prej tij, te gjitha apo nje pjese te kompetencave qe i jane dhene atij sipas statutit dhe qe i njihen nga legjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare.
- Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor 2002.

Ky Akt i Themelimit te shoqerise New York University -Tirana Sh.p.k. perpilohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe, nenshkruset rregullisht nga themeluesit e saj, pas perkthimit nga shqipja ne anglisht te Znj. Vilma Gjyshi te njohur prej meje noterit ne cilesine e perkthyesit, dhe une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

**THEMELUESIT**

ILIAS FOUTSIS

Charikleta Zachariadou


GENC RULI

NOTERI  
Halim Islami



**Perkthyer nga Shqipja ne Anglisht  
Nga Vilma Gjyshi**

Faqja 2 nga 2



**STATUTI  
I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
NEW YORK UNIVERSITY-TIRANA Sh.p.k.**



**I. EMERTMI, ORTAKET, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA**

**Neni 1**

Emri i shoqerise eshte New York University - Tirana Shpk., me poshte e quajtur "Shoqeria".

**Neni 2**

Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar, me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane

**Neni 3**

Shoqeria e ka seline e saj ne adresen: Instituti i Studimeve Bashkekohore, Rruga Vaso Pasha, nr.7, Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te hape filiale, dege dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

**Neni 4**

Shoqeria ka per objekt te kryeje dhe te marre pjese ne te gjitha aktivitetet dhe bizneset qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne baze te legjislacionit shqiptar per ngritjen dhe funksionimin e nje shkolle te larte jo publike te nivelit universitar ne deget e shkencave te natyres, te artit dhe profesioneve te lira. Te organizoje programet e edukimit profesional, seminare, kurse per mesimin e gjuheve te huaja te te gjitha niveleve si dhe çdo veprimtari tjetere ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 5**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

**Neni 6**

Ortakët e shoqërisë janë :

- Z. Ilias Foutsis, shtetas grek, lindur në Messinias, më 09.09.1948, mbajtes i pasaportës me nr. M 524049 ;  
Znj. Charikleta Zachariadou, shtetase greke, lindur në Thessalonikis, më 28.07.1945, mbajtes i pasaportës me nr. O 819181 ;  
Z. Genc Ruli, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 11.04.1958, mbajtes i pasaportës me nr.0011318 .

## II. KAPITALI FILLESTAR I SHOQËRISE

### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.000.000 Leke ( tre milion) i cili është i ndarë në 300 (treqind) kuota me vlerë nominale 10.000 Leke (dhjetë mijë) secila. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet dhe derdhet teresisht në të holla, përkatësisht nga ortakët:

Z. Ilias Foutsis, zoteron 195 (njëqind e nënëtdhjetë e pesë) kuota që korrespondojnë 1.950.000 Leke ( një milion e nënëtdhjetë e pesëdhjetë mijë), që përfaqëson 65 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Z. Genc Ruli i cili zoteron 75 (shtatëdhjetë e pesë) kuota, që i korrespondojnë 750.000 Leke (shtatëqind e pesëdhjetë mijë), që përfaqëson 25 % të kapitalit të shoqërisë;

Zj. Charikleta Zachariadou e cila zoteron 30 (tridhjetë) kuota, që i korrespondojnë 300.000 Leke (treqind mijë), që përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë;

Kuotat e kapitalit janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo moment sipas ligjit shqiptar në fuqi.

Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërisë kundër të tretëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.



## III. ORGANET E SHOQËRISE

1. ASAMBLEJA E ORTAKEVE
2. ADMINISTRATORI I VETEM

### Neni 8

Asambleja e Ortakëve e thirrur rregullisht është organi suprem i shoqërisë. Vendimet e saj janë të detyrueshme për të gjithë ortakët panvaresisht nga prania në mbledhje dhe si kanë votuar.

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë sipas legjislacionit shqiptar mund të marrin çdo lloj vendimi e pa asnjë kufizim, me

perjashtim te atyre vendimeve qe jane kompetence e administratorit.

Asambleja e ortakeve merr vendime per ndryshimin e ketij statuti, shperndarjen e shoqerise, kooperimin ne çfaredo lloj forme me shoqeri te tjera, shtimin ose pakesimin e kapitalit te shoqerise dhe/ose te kuotave te tij, transferimin e nje pjese

apo te gjithë kuotave te kapitalit te shoqerise, emerimin dhe shkarkimin e administratorit, aprovimin e raporteve financiare dhe bilancit brenda gjashte muajve nga perfundimi i vitit financiar te shoqerise, blerjen dhe shitjen e pasurive te paluajtshme.

#### Neni 9

Asambleja e Ortakeve thirret nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne te pakten 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar. Në mbledhjet e saj, vendimet e vlefshme merren nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaket nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

#### Neni 10

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i zgjedhur nga Asambleja e Ortakeve. Administratori do te qendrojne ne detyre deri ne momentin e revokimit te mandatit te tij nga Asambleja e Ortakeve.

Ortaket emerojne administrator te pare te shoqerise Z. Ilias Foutsis, shtetas grek, lindur ne Messinias, me 09.09.1948, mbajtes i pasaportes me nr. M 524049.

Administratorit i njihet e drejta t'u delegoje me prokure personave te trete te zgjedhur prej tij, nje pjese apo te gjitha kompetencat qe i jane caktuar atij sipas ketij statuti dhe qe i njihen nga legjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare.

Administratori do te pergjigjet per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, dhe do t'a realizoje ate duke kryer te gjitha veprimet qe ai i konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te shoqerise me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Asamblese se Ortakeve.

Administratori do te pergjigjet personalisht perballe shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjit dhe/ose te statutit.

Ne rast shkelje te ligjit, Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment me vendim te autoritetit gjyqesor shqiptar.

### IV. VITI FINANCIAR, EKSPERTET KONTABEL, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

#### Neni 11

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar

fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2002.

**Neni 12**

Asambleja e Ortakeve do te emeruje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tij behet i nevojshem ne baze te ligjit shqiptar.

**Neni 13**

Ne çdo moment e per çdo arsye qe arrihet ne shperndarjen e shoqerise, normat per kryerjen e likuidimit dhe emerimin e likuidatorit jane ato qe parashikohen nga ligji shqiptar ne fuqi.

**Neni 14**

**Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen normat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

Çdo konflikt qe mund te lindet ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Statuti, si dhe çdo konflikt qe mund te lindet midis Shoqerise dhe te treteve do te jete objekt i zgjidhjes nepermjet vendimit te Gjykatave Shqiptare.


**Neni 14**

**Ndryshimet**


Statuti mund te ndyshohet, rishikohet, shfuqizohet i teri e te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Nenshkruhet sot me date 16. 4. 2002

**ORTAKET**

  
\_\_\_\_\_  
GENC RULI

\_\_\_\_\_  
Harris Raclowiadon

  
Perkthyer nga Shqipja ne Anglisht  
\_\_\_\_\_  
VILHJELM CASHA

Shume e Notarëve  
No. 217; Rep.  
A. 128 Kol.

Notari,  
Shkëlqim  
